

**VENDIM**  
**Nr.9, datë 13.1.2000**

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.562, DATË 2.12.1999, TË KËSHILLIT TË**  
**MINISTRAVE, “PËR PRANIMIN E KËRKESAVE PËR STATUSIN E VETERANIT TË**  
**LUFTËS KUNDËR PUSHTUESVE NAZIFASHISTË TË POPULLIT SHQIPTAR”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, 8, dhe 14, të ligjit nr. 7874, datë 17.11.1994, “Për statusin e veteranit të luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar”, ndryshuar në ligjin nr. 8526, datë 23. 9. 1999, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Në vendimin nr.562, datë 2.12.1999 të Këshillit të Ministrave, “Për pranimin e kërkesave për statusin e veteranit të luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar”, bëhen këto ndryshime:

1. Në titullin e vendimit dhe në pikën 1 të këtij vendimi fjalët “kundër pushtuesve nazifashistë” zëvendësohen me fjalët “të Luftës Antifashiste, Nacionalçlirimtare”.
  2. Në rreshtin e parë të pikës 6, shifra “3” zëvendësohet me shifrën “4” dhe fjalët "dhe shprehja "të komisioneve të rretheve"" hiqen.
  3. Në paragrafin e dytë të pikës 6, pas fjalës “Gjithashtu”, shtohen fjalët "shprehja "të komisioneve të rretheve"".
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYEMINISTRI**  
**Ilir Meta**